



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.95	2004	17 dhjetor
--------------	-------------	-------------------

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9313 datë 11.11.2004	Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës italo-shqiptare.....	6563
Ligj nr.9314 datë 11.11.2004	Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.....	6564
Ligj nr.9315 datë 11.11.2004	Për dërgimin e kompanisë paqeruajtëse shqiptare në Bosnjë-Hercegovinë për të marrë pjesë në operacionin “ALTHEA” të Bashkimit European.....	6565
Ligj nr.9317 datë 18.11.2004	Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë.....	6566
Ligj nr.9318 datë 18.11. 2004	Për disa ndryshime në ligjin nr.8615, datë 1.6.2000 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”.....	6585

LIGJ
Nr.9313, datë 11.11.2004

**PËR PRIVATIZIMIN E AKSIONEVE, PRONË E SHTETIT SHQIPTAR, TË BANKËS
ITALO-SHQIPTARE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ministria e Financave, me cilësinë e pronarit, lejohet, në emër të shtetit shqiptar, të transferojë të drejtën e pronësisë nëpërmjet shitjes së 40 për qind të aksioneve të Bankës Italo-Shqiptare.

Neni 2

1. Aksionet, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës Italo-Shqiptare, t'u ofrohen për shitje, fillimisht, aksionerëve të kësaj banke, sipas legjislacionit në fuqi dhe aktit të themelimit të saj.

2. Në rast se edhe aksionerët e tjerë vendosin transferimin e të drejtës së pronësisë të aksioneve të tyre, të kësaj banke, procedura për shitjen e tyre të bëhet sipas marrëveshjes së aksionerëve, e cila, për pjesën e aksioneve të shtetit shqiptar, miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

1. Transferimi i të drejtës së pronësisë të këtyre aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës Italo-Shqiptare, për rastet e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, të kryhet vetëm pas vlerësimit të çmimit të aksioneve nga një vlerësues i njohur ndërkombëtar.

2. Përzgjedhja e vlerësuesit ndërkombëtar në rastin e pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, të bëhet me tender të hapur ndërkombëtar, ndërsa në rastin e pikës 2 të po këtij neni të bëhet sipas marrëveshjes së aksionerëve.

Neni 4

1. Nëse shitja e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës Italo-Shqiptare nuk realizohet brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, Ministria e Financave ka të drejtën t'ia shesë ato, nëpërmjet tenderit të hapur, një investitori strategjik të njohur në sektorin bankar, i cili ofron garanci financiare.

2. Procedurat e përzgjedhjes së investitorit strategjik, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Përcaktimi i vlerës së aksioneve për fillimin e procedurave të tenderit, sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij ligji, bëhet pas vlerësimit të aksioneve të Bankës Italo-Shqiptare nga një vlerësues ndërkombëtar, i përzgjedhur me tender të hapur ndërkombëtar.

Neni 6

Këshilli i Ministrave miraton vlerën e aksioneve, të përcaktuar nga vlerësuesi ndërkombëtar, sipas parashikimeve të nenit 3 pika 1 dhe të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 7

1. Të ardhurat që sigurohen nga privatizimi i aksioneve të kësaj banke derdhen në Buxhetin e Shtetit pasi të jenë zbritur shpenzimet që do të përdoren për realizimin e procesit të shitjes, të cilat nuk duhet të kalojnë shumën 10 për qind të vlerës së shitjes.

2. Kriteret për përdorimin e shumës deri në 10 për qind të vlerës së shitjes, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4415, datë 13.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Aldred Moisiu

L I G J

Nr.9314, datë 11.11.2004

PËR PRIVATIZIMIN E AKSIONEVE, PRONË E SHTETIT SHQIPTAR, TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ministria e Financave, me cilësinë e pronarit, lejohet, në emër të shtetit shqiptar, të transferojë të drejtën e pronësisë nëpërmjet shitjes së 40 për qind të aksioneve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.

Neni 2

Aksionet, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, t'u ofrohen për shitje, fillimisht, aksionerëve të kësaj banke, sipas legjislacionit në fuqi dhe aktit të themelimit të saj.

Neni 3

Transferimi i të drejtës së pronësisë të këtyre aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, tek aksionerët e kësaj banke të kryhet vetëm pas vlerësimit të çmimit të aksioneve nga një vlerësues i njohur ndërkombëtar, i përzgjedhur me tender të hapur ndërkombëtar.

Neni 4

1. Nëse shitja e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nuk realizohet brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas parashikimeve të nenit 2 të këtij ligji, Ministria e Financave ka të drejtën t'ia shesë ato, nëpërmjet tenderit të hapur, një investitori strategjik të njohur në sektorin bankar, i cili ofron garanci financiare.

2. Procedurat e përzgjedhjes së investitorit strategjik, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Përcaktimi i vlerës së aksioneve për fillimin e procedurave të tenderit, sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij ligji, bëhet pas vlerësimit të aksioneve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga një vlerësues ndërkombëtar, i përzgjedhur me tender të hapur ndërkombëtar.

Neni 6

Këshilli i Ministrave miraton vlerën e aksioneve, të përcaktuar nga vlerësuesi ndërkombëtar, sipas parashikimeve të neneve 3 e 5 të këtij ligji.

Neni 7

1. Të ardhurat që sigurohen nga privatizimi i aksioneve të kësaj banke derdhen në Buxhetin e Shtetit pasi të jenë zbritur shpenzimet që do të përdoren për realizimin e procesit të shitjes, të cilat nuk duhet të kalojnë shumën 10 për qind të vlerës së shitjes.

2. Kriteret për përdorimin e shumës deri në 10 për qind të vlerës së shitjes, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4416, datë 13.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Aldred Moisiu

L I G J

Nr.9315, datë 11.11.2004

PËR DËRGIMIN E KOMPANISË PAQERUAJTËSE SHQIPTARE NË BOSNJË-HERCEGOVINË PËR TË MARRË PJESË NË OPERACIONIN “ALTHEA” TË BASHKIMIT EUROPIAN

Në mbështetje të neneve 12 pika 3 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Dërgohet një kompani shqiptare në Bosnjë-Hercegovinë për të marrë pjesë në operacionin "ALTHEA" të Bashkimit Europian, në zbatim të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr.1551, datë 9.7.2004.

Neni 2

Statusi i kësaj force të jetë ai i përcaktuar në marrëveshjen "SOFA", miratuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, lidhur me statusin e forcave".

Neni 3

Ushtarakët, që do të marrin pjesë në operacionin "ALTHEA", për ditët e qëndrimit në këtë operacion, veç pagës mujore, marrin, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, në masën që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ministria e Mbrojtjes të marrë të gjitha masat organizative e teknike për realizimin e detyrave nga kompania paqeruajtëse.

Neni 5

Ligji nr.8139, datë 5.9.1996 "Për dërgimin e kompanisë paqeruajtëse shqiptare për të marrë pjesë në operacionin e NATO-s "Përpjekja e përbashkët" në ish-Jugosllavi", shfuqizohet.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4417, datë 13.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Aldred Moisiu

LIGJ

Nr.9317, datë 18.11.2004

KODI HEKURUDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

KREU I
OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT, SUBJEKTET DHE PËRCAKTIMET

Neni 1
Objekti

Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë ka për objekt përcaktimin dhe vendosjen e rregullave dhe parimeve të përgjithshme në fushën e transportit hekurudhor dhe të veprimtarive që lidhen me të.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij Kodi shtrihen mbi të gjitha objektet dhe veprimtaritë hekurudhore në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe degëzimet e vijat e brendshme hekurudhore, stacionet hekurudhore, ndërtimet e shërbimet për udhëtarët, magazinimin dhe përpunimin e mallrave, të gjitha mjetet hekurudhore, bazat e riparimit të mjeteve e të vijave, pajisjet e sinjalizimit e të ndërlidhjes.

2. Aspektet, që lidhen me veprimtarinë hekurudhore, të cilat nuk rregullohen shprehimisht në këtë Kod, i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me të.

3. Veprimtaritë hekurudhore të subjekteve të regjistruara në Shqipëri, por që e ushtrojnë këtë veprimtari në territoret e shteteve të tjera, realizohen në përputhje me legjislacionin e atij vendi, duke iu përmbajtur, për aq sa është e mundur, këtij Kodi dhe legjislacionit shqiptar në përgjithësi.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllimet e këtij Kodi, termat e përdorur në të kanë kuptimin si më poshtë:

1. "Transportues hekurudhor" është çdo person juridik, publik ose privat, i autorizuar për të transportuar udhëtarë dhe/ose mallra me hekurudhë dhe që e siguron vetë tërheqjen.

2. "Administrues infrastrukture" është personi juridik, publik ose privat, pronar ose jo i një infrastrukture hekurudhore, që e administron dhe e mirëmban atë për ta shfrytëzuar vetë ose nëpërmjet të tretëve.

3. "Transportues hekurudhor i integruar" është një transportues hekurudhor, që është edhe një administrues infrastrukture.

4. "Infrastrukturë hekurudhore" është tërësia e të gjitha vijave hekurudhore, e degëzimeve hekurudhore, e pajisjeve dhe e instalimeve të ndërlidhjes, të sinjalizimit dhe elektrike, të domosdoshme për qarkullimin e mjeteve hekurudhore dhe për sigurinë e trafikut.

5. "Hekurudha Shqiptare" (në vijim do të përdoret HSH) është ndërmarrja hekurudhore publike e integruar, që kryen edhe drejtimin operativ e të vazhdueshëm të lëvizjes tërësore të trenave.

6. "Veprimtari hekurudhore" është tërësia e veprimtarive transportuese ose të shërbimit që lidhet me rrjetin hekurudhor.

7. "Rrjet hekurudhor" është tërësia e vijave hekurudhore që shërbejnë për transportimin e udhëtarëve dhe të mallrave.

8. "Vijë hekurudhore" është ajo pjesë e infrastrukturës hekurudhore, me të gjitha elementet përbërëse të përcaktuara në këtë Kod, mbi të cilën realizohet qarkullimi i mjeteve hekurudhore.

9. "Stacion hekurudhor" është vendi ku realizohen, pjesërisht ose tërësisht, shërbimet e domosdoshme për transportin e udhëtarëve e të bagazheve, për transportin e mallrave dhe për drejtimin e organizimin e punës për qarkullimin, formimin e shformimin e trenave dhe nisjen e tyre.

10. "Degëzim hekurudhor" është vija hekurudhore që lidh stacionin ose vijën hekurudhore kryesore me vijat e brendshme hekurudhore, që ndodhen në territorin e personave juridikë.

11. "Brez i vijës hekurudhore" është toka në të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi minimale 5 metra, duke u nisur nga fundi i skarpatës së trasesë, kur nuk ka kanale, dhe nga fundi i kanaleve mbrojtëse dhe kulluese.

12. "Brez mbrojtës i vijës hekurudhore" është brezi i tokës nga të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi 100 metra, nisur nga ekstremi i jashtëm i brezit hekurudhor.

13. "Hapësirë ajrore e vijës" është hapësira mbi brezin e vijës hekurudhore, në lartësi 12 metra nga niveli i shinës, në të gjithë gjerësinë e brezit të vijës hekurudhore.

14. "Material hekurudhor" është çdo mjet dhe pajisje hekurudhore, të destinuar për t'u përdorur në veprimtarinë hekurudhore.

15. "Mjet hekurudhor" është çdo mjet, i aftë për të qarkulluar mbi rrotat e veta mbi vijat hekurudhore, me ose pa tërheqje.

16. "Mjet hekurudhor tërheqës" është mjeti hekurudhor, me pajisje tërheqjeje, që shërben për të tërhequr mjete të tjera hekurudhore.

17. "Vagon hekurudhor" është mjeti hekurudhor, i papajisur me pajisje tërheqëse, i destinuar për transportin e udhëtarëve, të mallrave, të bagazheve dhe të kolive ekspres.

18. "Pranim teknik" është vlerësimi teknik nga organi përgjegjës që mjeti ose materiali tjetër hekurudhor të përdoret në veprimtarinë hekurudhore.

19. "Pranim shfrytëzimi" është e drejta e dhënë nga autoriteti përgjegjës, që mjeti hekurudhor të përdoret në veprimtarinë hekurudhore.

20. "Kalesë hekurudhore" është sipërfaqja ku vija hekurudhore ndërpritet, në të njëjtin nivel, me rrugën automobilistike.

21. "Standard teknik" është një specifikim teknik, kombëtar ose ndërkombëtar, i miratuar nga organi përkatës shtetëror.

22. "Territor hekurudhor" është sipërfaqja e veçuar e truallit ose e tokës, e destinuar për shfrytëzimin ose mbrojtjen e vijave hekurudhore, së bashku me ndërtimet, pajisjet dhe instalimet, që u shërbejnë transportit hekurudhor dhe stacionimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve hekurudhore.

23. "Trafik hekurudhor" është tërësia e mjeteve hekurudhore, që qarkullojnë në rrjetin hekurudhor, në tërësi ose në vija të veçanta, në kohë e periudha të caktuara.

24. "Tren" është vargu i formuar dhe i lidhur i vagonëve hekurudhorë me një mjet ose me disa mjete tërheqëse.

25. "Ministria" është ministria përgjegjëse që mbulon veprimtarinë e transporteve në tërësi dhe që ka fushë të veprimtarisë bashkërendimin e drejtimit dhe kontrollin e veprimtarisë hekurudhore.

26. "Ministër" është personi përgjegjës për veprimtarinë e transportit, përfshirë dhe atë hekurudhor.

Termet e tjerë të përdorur, por të papërcaktuar në këtë Kod, kanë kuptimin e dispozitave ligjore të fushës përkatëse dhe, në mungesë të tyre, kuptimin fillestar të fjalës.

Neni 4 Subjektet

Subjekte të këtij Kodi janë ministria që mbulon veprimtarinë e transporteve, Hekurudha Shqiptare dhe personat juridikë e fizikë vendas dhe të huaj që ushtrojnë veprimtari në fushën e transportit hekurudhor dhe të veprimtarive që lidhen me të, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod.

Neni 5 Detyrimet e subjekteve

Në veprimtarinë hekurudhore subjektet janë të detyruara të veprojnë në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, legjisllacionin në fuqi, si dhe me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, në të kundërt, kur është rasti, mbajnë përgjegjësi penale, civile ose administrative, në bazë të dispozitave përkatëse ligjore në fuqi.

Neni 6

Marrja e cilësisë së subjektit

1. Personat juridikë, publikë privatë, marrin cilësinë e transportuesit hekurudhor me të drejtat dhe detyrimet përkatëse në veprimtarinë hekurudhore pas marrjes së lejes së veprimtarisë, dhënë nga ministria përkatëse, sipas kriterëve të miratuara nga ministri me akt nënligjor.

2. Personat fizikë realizojnë detyra ose punësohen në veprimtarinë e drejtimit të mjeteve tërheqëse, të lëvizjes e të drejtimit të trenave, të instalimit dhe të mirëmbajtjes së sistemeve të sinjalizimit e të ndërlikdhjes, të kontrollit teknik të mjeteve, materialeve e pajisjeve hekurudhore, pasi të plotësojnë kërkesat profesionale dhe t'i nënshtrohen testimit nga organi përkatës, i ngarkuar nga ministri, sipas rregullores së miratuar prej tij.

3. Transportuesit e huaj hekurudhorë, mbi bazën e parimit të reciprocitetit dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse ndërmjet shtetit ku ata janë regjistruar dhe shtetit shqiptar, mund të kryejnë veprimtari transportuese në rrjetin hekurudhor shqiptar për lëvizjen e mjeteve të transportit hekurudhor që kanë vetëm stacionin e origjinës ose të destinacionit në territorin shqiptar.

Neni 7

Detyrime të subjekteve të tjera

Personat fizikë dhe juridikë të tjerë, kur hyjnë në marrëdhënie juridike me subjekte të këtij Kodi ose shkaktojnë dëme në fushën e transportit hekurudhor, veprojnë dhe përgjigjen sipas legjislacionit në fuqi, për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në këtë Kod.

Neni 8

Të drejtat e pronësisë

1. Trualli, traseja dhe elementet përbërëse të vijës hekurudhore, sistemet e sinjalizimit e të ndërlikdhjes, linjat e saj elektrike, godinat dhe aparaturat e sistemit të drejtimit dhe të komandimit janë në pronësi të shtetit. Gjithashtu, në këtë pronësi mund të përfshihen edhe mjetet hekurudhore tërheqëse, transportuese dhe të shërbimit.

2. Prona hekurudhore publike, përveç objekteve që lidhen domosdoshmërisht me veprimtarinë shtetërore, sipas këtij Kodi, mund të shfrytëzohet drejtpërdrejt nga shteti, nga personat juridikë, publikë ose privatë, kundrejt tarifave të përcaktuara sipas dispozitave përkatëse ligjore.

3. Personat juridikë, publikë ose private, mund të kenë në pronësi truallin, trasenë, linjat elektrike përkatëse dhe elementet përbërëse të degëzimeve hekurudhore, si dhe mjetet hekurudhore të tërheqjes, të transportit e të shërbimit.

Neni 9

Veprimtari me burim rreziku të shtuar

1. Qarkullimi i trenave ose i mjetit tërheqës të veçuar, si dhe vagoni i ndaluar, magazina ose depozita e përkohshme apo e përhershme, me karburant, eksploziv, lëndë ndezëse, plasëse, helmuese ose çdo material tjetër, me rrezik për njerëzit dhe mjedisin, si dhe linjat e pajisjet elektrike, sistemet e sinjalizimit e të ndërlikdhjes në territorin hekurudhor përbëjnë veprimtari me burim rreziku të shtuar.

2. Veprimtaritë me burim rreziku të shtuar, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të ministrit.

KREU II VEPRIMTARIA HEKURUDHORE

Neni 10 **Mënyra e realizimit**

1. Veprimtaria hekurudhore realizohet nga persona juridikë, publikë e privatë, sipas këtij Kodi, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe të akteve ligjore e nënligjore të tjera që kanë për objekt ose lidhje me veprimtaritë që rregullon ky Kod.

2. Përjashtimisht nga përcaktimi i bërë në pikën 1 të këtij neni, veprimtari të tilla, si drejtimi qendror i lëvizjes së trenave, komandimi i sistemit të ndërlidhjes, i sinjalizimit, atij elektrik, lejimi i ndërtimeve e i punimeve në territorin hekurudhor, lejimi i kryerjes së veprimtarisë hekurudhore jashtë kufirit shtetëror, licencimi i subjekteve transportuese dhe testimi i punonjësve për detyra e vende të veçanta pune, realizohen vetëm nga ministria përkatëse, HSH-ja dhe Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, siç përcaktohet në këtë Kod.

Neni 11 **Bashkërendimi dhe kontrolli i veprimtarisë hekurudhore**

Bashkërendimi i drejtimit dhe kontrolli i të gjithë veprimtarisë hekurudhore kryhet drejtpërdrejt nga ministria që mbulon veprimtarinë hekurudhore ose nga HSH-ja dhe Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, si përcaktohet në këtë Kod.

Neni 12 **Hekurudha Shqiptare**

1. Hekurudha Shqiptare është ndërmarrje publike, me kapital tërësisht shtetëror. Ajo organizohet dhe vepron në formën e një shoqërie anonime, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për shoqëritë tregtare”.

2. HSH-ja ka për detyrë edhe administrimin e infrastrukturës hekurudhore dhe, nëpërmjet fondeve shtetërore, realizon investime në infrastrukturë për rinovimin e modernizimin, për mirëmbajtjen e zgjerimin e saj dhe për administrimin e sistemeve të drejtimit e të sigurisë.

KREU III INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE, NDARJA, NDËRTIMI, RIKONSTRUKSIONI DHE MIRËMBAJTJA E VIJËS HEKURUDHORE

Neni 13 **Vija hekurudhore**

1. Vija hekurudhore përbëhet nga:
- a) shtresa e poshtme, e cila përmban trupin e trasesë dhe tokën nën të;
 - b) shtresa e sipërme, e cila përmban ballastin, traversat, shinat dhe elementet lidhëse;
 - c) pajisjet në vijë, ku përfshihen ndërruesit dhe motorët e tyre;
 - ç) veprat e artit, urat, tunelet, viaduktet, muret mbrojtëse e mbajtëse, tombinot dhe tokën nën to;
 - d) brezi i vijës hekurudhore në të dyja anët e saj dhe hapësira ajrore e vijës;
 - dh) kanalet e kunetat e ujërave.
2. Për vijat hekurudhore respektohen kushtet dhe normativat teknike të përcaktuara në standardet teknike.

Neni 14

Klasifikimi i vijave hekurudhore

Vijat hekurudhore ndahen në:

- a) vija hekurudhore kryesore, që lidhin stacionet me njëri-tjetrin;
- b) vija hekurudhore të shërbimit në stacione, që përdoren për pranimin dhe nisjen e trenave, për manovrimin, formimin e shformimin e tyre, si dhe për ngarkimin e shkarkimin e trenave;
- c) vija të brendshme hekurudhore, që ndodhen në territoret e personave juridikë, publikë ose privatë, apo të institucioneve shtetërore dhe përdoren prej tyre;
- ç) degëzime hekurudhore, që lidhin stacionet me vijat e brendshme.

Neni 15

Kriteret e ndërtimit e të mirëmbajtjes së vijave hekurudhore

1. Vija hekurudhore projektohet, ndërtohet, rikonstruktohet, i bëhet remonti dhe mirëmbahet duke iu përgjigjur standardeve teknike, shpejtësisë së trenave dhe kërkesave për siguri në trafikun hekurudhor.

2. Vija hekurudhore, që shërben për trafikun ndërkombëtar, duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat vendi ynë është palë.

3. Për çdo punim në vijat hekurudhore duhet të respektohen kërkesat e dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe të mjedisit.

Neni 16

Kontrolli dhe kolaudimi teknik

Pas ndërtimit, rikonstruksioneve, remonteve të vijës hekurudhore, të objekteve dhe të pajisjeve në vijë, kryhet kontrolli teknik dhe kolaudimi i tyre, për të verifikuar zbatimin e standardeve teknike.

Neni 17

Bashkimi i vijave hekurudhore

Bashkimi i dy vijave hekurudhore bëhet në stacionet hekurudhore. Në raste të veçanta mund të kryhet edhe në vijë të hapur, me kusht që të zbatohen të gjitha kriteret e përcaktuara në udhëzimin e ministrit.

Neni 18

Ndalimi i ndërtimeve të tjera

1. Në brezin e vijës hekurudhore ndalohet ndërtimi i ndërtesave dhe i objekteve të tjera të çdo lloji, përveç objekteve të destinuara për vijën hekurudhore.

2. Për objektet jashtë veprimtarisë hekurudhore, ndërtimi i të cilave kryqëzohet me vijën hekurudhore, merret paraprakisht miratimi i HSH-së.

Neni 19

Zhvendosja e vijës hekurudhore

Zhvendosja e vijës hekurudhore, për shkak të ndërtimit të objekteve të tjera, kryhet vetëm pasi merret miratimi i HSH-së.

Pjesa e vijës hekurudhore, që do të zhvendoset, ndërtohet detyrimisht sipas standardeve teknike.

Shpenzimet për zhvendosjen e vijës hekurudhore i ngarkohen investitorit të objektit, në interes të të cilit bëhet kjo zhvendosje.

KREU IV KALESAT HEKURUDHORE

Neni 20

Kërkesat për ndërtimin e kalesës hekurudhore

Ndërtimi i kalesës hekurudhore bëhet në përputhje me standardet teknike.

Pjesa e rrugës automobilistike, 3 metra nga të dyja anët e aksit të vijës hekurudhore, është pjesë përbërëse e kësaj vije.

Largësia ndërmjet dy kalesave hekurudhore të njëpasnjëshme nuk mund të jetë më pak se 2500 metra.

Neni 21

Kushtet teknike për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kalesave hekurudhore

Kushtet teknike të ndërtimit, të funksionimit dhe të mirëmbajtjes së kalesave hekurudhore, të mbikalimeve dhe të nënkalimeve hekurudhore përcaktohen në udhëzimin e ministrit.

Për ndërtimin e një kalese hekurudhore, organet e pushtetit vendor ose personat juridikë të interesuar marrin miratimin e HSH-së.

Shpenzimet për ndërtimin dhe shfrytëzimin e kalesave të reja hekurudhore përballohen nga personi juridik i interesuar, që bën kërkesën për ndërtimin e saj.

Neni 22

Përgjegjësia për kalesat hekurudhore të parregullta

1. HSH-ja nuk mban përgjegjësi për aksidentet dhe avaritë që ndodhin në kalesat hekurudhore, të ndërtuara në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi.

2. Personat juridikë ose fizikë, që kanë ndërtuar kalesën hekurudhore në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, organi përkatës që ka miratuar punimet e parregullta për ndërtimin e saj ose administruesi i infrastrukturës së pjesës së vijës ku është ndërtuar kalesa hekurudhore e parregullt, mbajnë përgjegjësi, sipas rastit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë Kod.

Neni 23

Kriteret e ndërtimit sipas llojit të kalesës hekurudhore

1. Projektimi dhe ndërprerja e autostradave, e rrugëve interurbane dhe urbane, kryesore, me vijat hekurudhore ekzistuese realizohet me mbikalim ose nënkalim rrugor.

2. Projektimi dhe ndërtimi i ndërprerjeve të vijave të reja kryesore hekurudhore me autostradat, rrugët interurbane dhe urbane, kryesore, realizohet me mbikalime ose nën kalime hekurudhore.

3. Personat juridikë të interesuar për projektet e mbikalimit ose nënkalimit rrugor/hekurudhor këshillohen me HSH-në përpara se të marrin miratimin e saj.

Neni 24

Kalesa hekurudhore të ndaluara

Nuk lejohet ndërtimi i kalesave hekurudhore brenda territorit të stacionit hekurudhor.

Neni 25

Mirëmbajtja e kalesave hekurudhore ekzistuese

1. HSH-ja dhe personi juridik që mirëmban rrugën, me marrëveshje, ndërmjet tyre, përcaktojnë marrëdhëniet e ndërsjella për detyrimet teknike dhe financiare për çdo kalesë hekurudhore.

2. Në marrëveshje, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen, kryesisht, lloji dhe vëllimi i punimeve për mirëmbajtjen, koha e kryerjes së punimeve, shpenzimet për sigurimin e pandërprerë dhe të sigurt të trafikut hekurudhor, mirëmbajtja e pajisjeve të sinjalizimit dhe të ndërlidhjes.

KREU V

SISTEMET E NDËRLIDHJES DHE TË SINJALIZIMIT

Neni 26

Sistemi i ndërlidhjes

1. Sistemi i ndërlidhjes ndërtohet dhe mirëmbahet në mënyrë të tillë që të plotësojë nevojat për një lëvizje të sigurt të trenave e të mjeteve hekurudhore.

2. Kushtet teknike për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e sistemit të ndërlidhjes në rrjetin hekurudhor përcaktohen në rregulloren përkatëse, të miratuar nga ministri me propozimin e HSH-së.

Neni 27

Sistemi i sinjalizimit

Sistemi i sinjalizimit shërben për rritjen e sigurisë së lëvizjes së trenave, të kryerjes së manovrës në stacionet hekurudhore dhe të automatizimit të procedurave të pranimiit e të nisjes së trenave, nëpërmjet pajisjeve e shenjave të sinjalizimit.

Neni 28

Përcaktimi i sistemit të ndërlidhjes e të sinjalizimit

Pajisjet e ndërlidhjes e të sinjalizimit, shenjat dhe shenjëzimet në vijën dhe në degëzimet hekurudhore, lloji, rëndësia, forma, ngjyra, sistemet e sinjalizimit dhe rregullat e përdorimit e të mirëmbajtjes së tyre përcaktohen në rregulloren përkatëse, të miratuar nga ministri, në përputhje me standardet e Komunitetit European.

KREU VI

MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

Neni 29

Kontrolli dhe mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore

1. Infrastruktura hekurudhore kontrollohet dhe mirëmbahet nga administruesi i saj me qëllim për të siguruar dhe garantuar një trafik të sigurt të lëvizjes së mjeteve hekurudhore.

2. Rregullorja për kontrollin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore miratohet nga ministri.

Neni 30

Administrimi dhe mirëmbajtja e degëzimeve hekurudhore ekzistuese

Degëzimet hekurudhore ekzistuese janë pronë shtetërore dhe administrohen e mirëmbahen nga HSH-ja.

Neni 31

Lidhja dhe ndërtimi i degëzimeve të reja hekurudhore

Lidhjet e degëzimeve të reja hekurudhore të personave juridikë të tjerë me vijat hekurudhore në administrim të HSH-së rregullohen me marrëveshje ndërmjet tyre.

Degëzimet e reja hekurudhore ndërtohen me shpenzimet e personit juridik, të cilit i shërbejnë.

Neni 32

Administrimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore në territorin e personave juridikë

Infrastruktura hekurudhore që ndodhet në territorin e personave juridikë, publikë e privatë, administrohet dhe mirëmbahet prej tyre.

KREU VII

MBROJTJA E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

Neni 33

Masat për mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore

Administruesit hekurudhorë marrin masat e duhura për mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore, në përputhje me rregullat e përcaktuara me akt nënligjor të ministrit.

Neni 34

Mbrojtja e vijave dhe e degëzimeve hekurudhore

Vijat dhe degëzimet hekurudhore në administrim të HSH-së mbrohen prej saj.

Degëzimet e reja hekurudhore, pronë e personit juridik, publik ose privat, mbrohen nga personi juridik, të cilit i shërbejnë.

Neni 35

Kufizime në funksion të mbrojtjes së vijës hekurudhore

1. Për të siguruar mbrojtjen e vijave hekurudhore, ndalohet:

a) derdhja e ujërave të kanaleve ujtëse e kulluese dhe e ujërave të tjera në vijën hekurudhore ose në kanalet e trasesë së saj;

b) ndërhyrja në sistemin e kullimit të ujërave nga kanalet e trasesë së hekurudhurës deri në derdhjen përfundimtare;

c) hapja më afër se 100 metra nga brezi i vijës hekurudhore i guroreve, zhavorishteve e ranishteve, gërmimi masiv i dheut dhe hapja e kanaleve.

Edhe për ndërtimin e këtyre objekteve, në distancë 100-200 metra nga brezi i vijës hekurudhore, merret leje nga HSH-ja;

ç) kalimi i mjeteve me zinxhirë dhe i mjeteve të tjera të rënda mbi vijën hekurudhore, me përjashtim të rasteve kur HSH-ja cakton vendet e lejuara dhe rregullat për kalimin e tyre;

d) çdo lloj ndërtimi, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë vijës hekurudhore, më pranë se 25 metra nga brezi i kësaj vije, për territoret jashtë zonave urbane. Por, në këto zona, lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit dhe i ndërtesave të tjera, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë brezit të vijës hekurudhore, në distancë 25 - 100 metra nga ky brez.

2. Për ndërtimin e çdo lloj objekti, që ndodhet në zonat urbane, jashtë brezit të vijës hekurudhore, dhe në distancë deri në 25 metra nga ky brez, kërkohet leje nga HSH-ja.

Neni 36

Punimet në brezin mbrojtës të vijës hekurudhore

1. Në brezin mbrojtës të vijës hekurudhore mund të bëhen punime për vendosjen e ujësjellsave, kanalizimeve, tubacioneve, përcjellësve elektrikë, telefonikë dhe objekteve të ngjashme, me kusht që të mos pengojnë regjimin e trafikut hekurudhor dhe të mos dëmtojnë stabilitetin e vijës hekurudhore.

2. Në rastin e kryqëzimeve të vijës hekurudhore me rrjetin elektrik, telefonik ose teleferik apo të rrjeteve të ngjashme me to, këto duhet të vendosen jashtë gabariteve të hapësirës ajrore të vijës hekurudhore.

3. Për kryerjen e punimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, jepet miratimi nga HSH-ja, me kërkesë të personit juridik, i cili do të kryejë punimet.

4. Për miratimin e kryerjes së punimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, HSH-ja është e detyruar të njoftojë Drejtorinë e Inspektimit Hekurudhor të paktën 15 ditë para fillimit të punimeve.

Neni 37

Punimet mbrojtëse

Punimet për mbrojtjen e vijave hekurudhore dhe të objekteve mbi to, punimet për rregullsinë dhe sigurinë e trafikut ose për veprime të tjera në vijën hekurudhore dhe në brezin e vijës hekurudhore kryhen vetëm me miratimin e HSH-së.

Neni 38

Realizimi i punimeve mbrojtëse

HSH-ja dhe administrues të tjerë të degëzimeve hekurudhore e të vijave të brendshme hekurudhore janë të detyruar që në terrene të vështira, në terrene të ekspozuara ndaj erërave të fuqishme, erozionit të lumenjve, të cilat mund të shkaktojnë ndërprerje ose rëndim të trafikut hekurudhor, vetë apo së bashku me persona të tjerë juridikë, të përcaktojnë dhe të marrin masat e nevojshme teknike për mbrojtjen e vijave hekurudhore dhe të objekteve në vijë nga fatkeqësitë natyrore, për sigurimin e lëvizjes së pandërprerë të trafikut hekurudhor.

Neni 39

Ngarkimi dhe shkarkimi i mallrave përgjatë vijës hekurudhore

1. Ndalohet ngarkimi dhe shkarkimi i mallrave përgjatë vijës hekurudhore jashtë stacioneve hekurudhore.

2. Nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni bëjnë përjashtim vetëm ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve inerte dhe i materialeve të tjera, për qëllime mbrojtjeje, për mirëmbajtjen, riparimin ose rikonstrukcionin e vijës hekurudhore.

Neni 40

Përgjegjësia për dëmtimet

Dëmtimi, shkatërrimi dhe ndërhyrja në kundërshtim me rregullat e përcaktuara sipas këtij

Kodi, në çdo pjesë të infrastrukturës hekurudhore dhe në drejtimin e lëvizjes hekurudhore, kur nuk përbën vepër penale është kundërvajtje administrative dhe dënohet në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.

Neni 41

Përfshirja nga detyrimet fiskale

Trualli dhe toka ku shtrihen vijat hekurudhore, brezi i vijës hekurudhore, territori i stacioneve hekurudhore, që janë pronë shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi, përfshihen nga të gjitha detyrimet fiskale.

KREU VIII

SIGURIMI I TRAFIKUT HEKURUDHOR

Neni 42

Zbatimi i rregullave për sigurimin e trafikut

Transportuesit dhe administruesit hekurudhorë janë të detyruar të veprojnë në përputhje me rregullat e trafikut, të sinjalizimit të trafikut të përcaktuara në rregulloren e shfrytëzimit teknik të hekurudhave, të miratuar nga ministri, për realizimin e një trafiku hekurudhor të sigurt, të rregullt e të pandërprerë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 43

Organizimi i kontrolleve

1. Transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e infrastrukturës janë të detyruar të organizojnë dhe të kryejnë kontrolle të shpeshta për gjendjen dhe mirëmbajtjen e vijave hekurudhore, të objekteve, pajisjeve dhe aparaturave të ndryshme për një trafik hekurudhor të sigurt.

2. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e infrastrukturës janë të detyruar të kenë struktura të specializuara kontrolli.

3. Mënyrat dhe rregullat për kryerjen e kontrolleve përcaktohen në rregulloren për shfrytëzimin teknik të hekurudhave.

Neni 44

Masa të veçanta të sigurisë në stacionet hekurudhore

Mjediset dhe stacionet hekurudhore, për pranimin dhe nisjen e udhëtarëve e të bagazheve, duhet të kenë pajisje të përshtatshme, të domosdoshme, për shërbimin ndaj udhëtarëve dhe për kryerjen e sigurt të veprimtarisë hekurudhore.

Neni 45

Kalimi i vijës hekurudhore

1. Kalimi i vijës hekurudhore nga këmbësorët, mjetet rrugore ose kafshët kryhet vetëm në vendet e caktuara nga administruesi i infrastrukturës për këtë qëllim.

2. Vendet e kalimit duhet të tregohen me shenjat përkatëse e të pajisen me tabelat, me udhëzimet e domosdoshme.

Neni 46

Sigurimi i fushëpamjes

1. Për sigurimin e fushëpamjes gjatë lëvizjes së trenave në zonat urbane ndalohet që në anë të vijës hekurudhore:

a) të mbillen pemë me lartësi 1,5 metra ose të vendosen grumbuj materialesh me lartësi mbi 1,5 metra në distancën nga 0-6 metra nga brezi i vijës hekurudhore;

b) të mbillen pemë me lartësi mbi 4 metra ose të vendosen grumbuj materialesh me lartësi mbi 4 metra në distancën 6-25 metra nga brezi i vijës hekurudhore;

c) të vendosen burime drite me ngjyrën, formatin e sinjaleve e të shenjave hekurudhore ose të ndonjë objekti tjetër, që pengojnë drejtuesit e mjetit hekurudhor për të kuptuar sinjalin, në distancën 0-25 metra nga brezi i vijës hekurudhore.

2. Në këto raste administruesit e infrastrukturës i drejtohen organit përkatës të pushtetit vendor, për të mënjanuar pengesat e sipërpërmendura dhe nëse organi nuk merr masa të menjëhershme, ai ka të drejtë të veprojë vetë në bashkëpunim me organet e Rendit Publik.

Neni 47

Objektet e rëndësisë së veçantë

HSH-ja është e detyruar të përcaktojë objektet e rëndësisë së veçantë në kuadër të sigurisë së trafikut hekurudhor, si dhe të marrë masat përkatëse për mbrojtjen e tyre.

Neni 48

Ndalime të përgjithshme

Për realizimin e trafikut të sigurt hekurudhor është e ndaluar:

a) vendosja e çfarëdo sendi në vijën hekurudhore, në mjetet hekurudhore, në sistemin e sinjalizimit dhe të ndërlikimit, që cenon sigurinë e lëvizjes së trenave;

b) hapja e krahut të kalesës hekurudhore nga persona të paautorizuar, vendosja e çfarëdo gjëje mbi krahun e saj, dëmtimi i pajisjeve të sinjalizimit e të ndërlikimit të kalesës;

c) kryerja e punimeve në afërsi të kalesës hekurudhore, të cilat ulin ose pengojnë fushëpamjen e vijës hekurudhore;

ç) pengimi i punës së drejtuesit të lëvizjes së trenave në stacione, e makinistit, e punonjësit që mbikëqyr vijën hekurudhore, e punonjësit që shërben në kalesën hekurudhore, në urë, në tunel ose e ndonjë punonjësi tjetër hekurudhor gjatë trafikut hekurudhor;

d) lëvizja ose ndalimi i automjeteve, i karrove të tërhequra me kafshë në vendkalime të pamiratuara nga HSH-ja;

dh) qëndrimi ose lëvizja e njerëzve apo e kafshëve dhe kullotja e gjësë së gjallë mbi vijat hekurudhore;

e) ndezja e zjarreve, djegia e barit, e shkurreve dhe e të mbjellave brenda brezit të vijës hekurudhore.

Neni 49

Ndalimet për punonjësit hekurudhorë

1. Punonjësve, që merren me organizimin dhe kryerjen e transportit hekurudhor, u ndalohet:

a) lejimi i personave të paautorizuar të hyjnë në vendet e drejtimit të trenave, në lokomotivat, në mjetet e tjera dhe në të gjitha postet e lëvizjes së trenave;

b) drejtimi i mjetit hekurudhor dhe puna në postet e tjera të lëvizjes, jashtë kohës së shërbimit, me përjashtim të rasteve të forcave madhore ose të sëmundjeve të papritura;

c) përdorimi i pijeve alkoolike, i drogës ose i substancave psikotrope e narkotike, para dhe gjatë kryerjes së shërbimit;

ç) paraqitja në shërbim pa uniformë dhe pa pajisjet përkatëse për kryerjen e detyrës;

d) largimi nga vendi i shërbimit pa dorëzuar detyrën dhe pa u zëvendësuar nga punonjësi i ndërresës pasardhëse;

dh) zbatimi i shenjave dhe i urdhrave të paqartë;

e) fillimi i punës pa u njohur me parë me dokumentacionin teknik të stacionit;

ë) marrja e udhëtarëve pa biletë;

- f) puna pa dëshminë e aftësisë, për punën ose detyrën konkrete;
 - g) puna kur nuk kanë kaluar në kontrollet periodike të aftësisë për punë, sipas afateve të përcaktuara në rregulloret teknike;
 - gj) puna kur janë të paaftë për arsye shëndetësore e psikike;
 - h) puna kur janë konsumatorë kronikë të pijeve alkoolike, të drogës ose të substancave psikotrope e narkotike;
 - i) puna kur janë dënuar për krime në fushën e transportit hekurudhor;
 - j) kryerja e veprimeve të tjera, që bien në kundërshtim me këtë Kod, me rregulloren e shfrytëzimit teknik të hekurudhave dhe të dispozitave të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Në rregulloren e shfrytëzimit teknik të hekurudhave përcaktohen edhe kufizime të tjera, për të gjitha profesionet dhe vendet e punës.

Neni 50

Sigurimi i trafikut gjatë kryerjes së punimeve

1. Para fillimit të punimeve në vijën hekurudhore ose para fillimit të ndërtimeve të objekteve ose të vendosjes së pajisjeve në vijën hekurudhore, si dhe gjatë mirëmbajtjes së tyre, administruesi i infrastrukturës merr masat e domosdoshme për sigurimin e trafikut dhe sigurimin e punonjësve që kryejnë këto punime.

2. Për kryerjen e punimeve nga të tretë, ndërmjet tyre dhe administruesit të infrastrukturës bëhet një marrëveshje me shkrim, ku përcaktohen detyrimet përkatëse, sidomos për sigurinë e qarkullimit të trenave dhe të mjeteve të tjera hekurudhore.

3. Pas përfundimit të punimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, personi juridik, që ka kryer punimet, është i detyruar të largojë nga vija hekurudhore mjetet dhe materialet, mjetet e punës, shenjat e sinjalizimit dhe pajisjet e tjera, të vendosura gjatë dhe për kryerjen e punimeve dhe të rivendosë në funksionim pajisjet dhe aparaturat e sinjalizimit e të ndërlidhjes, si dhe pajisjet e tjera, të domosdoshme për trafik të sigurt hekurudhor.

KREU IX

MJETET HEKURUDHORE

Neni 51

Klasifikimi i mjeteve hekurudhore

Mjetet hekurudhore klasifikohen në:

- a) mjete tërheqëse, ku përfshihen lokomotiva ose lokomotiva - vagon;
- b) mjete që tërhiqen, ku përfshihen vagonët për transportin e udhëtarëve, të mallrave, të bagazheve dhe vagonët e shërbimit;
- c) mjete vetëlëvizëse, ku përfshihen drezinat, vinçat hekurudhorë dhe mjete të tjera me motor.

Neni 52

Karakteristika të mjeteve hekurudhore

Karakteristikat kryesore të mjeteve hekurudhore, që qarkullojnë në rrjetin hekurudhor të vendit, pajisjet dhe aparaturat e nevojshme, duhet të plotësojnë kushtet e pranimit teknik dhe të pranimit për shfrytëzim, të miratuara nga ministri, ndërsa mjetet hekurudhore, që qarkullojnë në rrjetin ndërkombëtar, duhet të plotësojnë standardet dhe normat teknike, të miratuara nga organizata "Bashkimi Ndërkombëtar i Hekurudhave".

Neni 53
Kontrolli teknik i mjeteve

Mjetet hekurudhore, për të garantuar lëvizjen e sigurt të tyre, u nënshtrohen kontrolleve teknike të programuara, si dhe kontrolleve operative, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e shfrytëzimit teknik të hekurudhave.

KREU X
**ORGANIZIMI I LËVIZJES SË TRENAVE E TË MJETEVE HEKURUDHORE DHE
ORGANIZIMI I TRANSPORTIT HEKURUDHOR**

Neni 54
Objektivat e organizimit të lëvizjes së trenave dhe mjeteve hekurudhore

Organizimi i lëvizjes së trenave dhe mjeteve hekurudhore, si dhe drejtimi i transportit hekurudhor ka për qëllim kryerjen e rregullt të transportit të udhëtarëve, të bagazheve dhe të mallrave, duke garantuar sigurinë e plotë të lëvizjes së trenave e të mjeteve hekurudhore në destinacionet përkatëse, sipas kohës së caktuar në grafikun e lëvizjes së tyre, mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të udhëtarëve, ruajtjen e mallrave e të bagazheve nga dëmtimet e shpërdorimet, parandalimin dhe shmangien e avarive dhe të aksidenteve, si dhe mbrojtjen nga çdo ngjarje natyrore ose ndërhyrje të padëshiruar.

Neni 55
**Organizimi i lëvizjes së mjeteve hekurudhore në vijat e brendshme hekurudhore të personave
juridikë**

Personat juridikë, që kanë vija të brendshme hekurudhore në territoret e tyre dhe që kanë në zotërim mjete tërheqëse, mund ta kryejnë vetë lëvizjen e mjeteve hekurudhore në territorin që administrojnë, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.

Neni 56
Ushtrimi i veprimtarisë nga transportuesit e tjerë hekurudhorë

Krahas HSH-së, në rrjetin hekurudhor mund të ushtrojnë veprimtari edhe transportues të tjerë hekurudhorë, të cilët pajisen për këtë qëllim me lejen përkatëse nga ministri. Kriteret për t'u pajisur me leje përcaktohen me akt nënligjor të ministrit.

Neni 57
Lejimi i vagonëve të huaj

Vagonët e huaj mund të qarkullojnë në të gjitha vijat hekurudhore të Republikës së Shqipërisë nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat është palë vendi ynë, si dhe nga dispozitat e këtij Kodi.

Neni 58
Grafiku i lëvizjes së trenave

1. Lëvizja e trenave kryhet sipas grafikut të përgjithshëm të lëvizjes së trenave, të hartuar pa diskriminim nga HSH-ja, si dhe pa cenuar lëvizjen e trenave dhe të mjeteve tërheqëse, të transportuesve të tjerë hekurudhorë.

2. Grafiku i përgjithshëm i lëvizjes së trenave përmban oraret dhe itineraret e lëvizjes së të gjithë trenave, të udhëtarëve e të mallrave.

3. Grafiku i lëvizjes së trenave të udhëtarëve publikohet në mjetet e informacionit publik dhe në stacionet hekurudhore, të paktën 15 ditë para hyrjes në fuqi.

Neni 59
Përdorimi i vijës hekurudhore

Rregullat për mënyrën e përdorimit të vijës hekurudhore nga transportuesit e ndryshëm hekurudhorë përcaktohen me akt nënligjor nga ministri.

Neni 60
Tarifat e përdorimit të vijës hekurudhore

Përdorimi i infrastrukturës nga transportuesit hekurudhorë kryhet kundrejt një tarife përdorimi, e cila propozohet nga ministria që mbulon transportet dhe miratohet nga Ministri i Financave.

KREU XI
TRANSPORTI HEKURUDHOR I UDHËTARËVE

Neni 61
Rregullimi ligjor i transportit të udhëtarëve

1. Transporti i udhëtarëve dhe i bagazheve kryhet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për kontratat e transportit.
2. Ministri nxjerr udhëzimin për mënyrën e zbatimit të këtyre rregullave në transportin e udhëtarëve e të bagazheve nga transportuesit publikë e privatë.

Neni 62
Kushtet dhe detyrimet e transportuesit

1. Transportuesit hekurudhorë, të autorizuar dhe që marrin përsipër transportin e udhëtarëve, janë të detyruar t'u sigurojnë atyre të gjitha kushtet e nevojshme, para dhe gjatë udhëtimit, si dhe të sigurojnë ruajtjen dhe trajtimin e bagazheve.
2. Në rast ndërprerjeje të udhëtimit për shkak të forcave madhore, të defekteve teknike ose për ndonjë faktor tjetër, që e bën të pamundur vazhdimin e mëtejshëm të udhëtimit, transportuesit hekurudhorë detyrohen t'i dërgojnë udhëtarët dhe bagazhet në stacionin hekurudhor të mbërritjes.
Kur kjo nuk është e mundur, udhëtarëve u kthehet vlera e biletës për pjesën e udhëtimit të përfunduar me hekurudhë, ndërsa kur dëshirojnë të qëndrojnë në stacionet e ndërmjetme ose të kthehen në stacionin e nisjes, u kthehet vlera e biletës.
3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, transportuesi hekurudhor detyrohet që bagazhet t'i transportojë sa më shpejt të jetë e mundur në stacionin e mbërritjes ose në një stacion të ndërmjetëm, pas kërkesës me shkrim të zotëruesit të bagazhit.
4. Stacionet hekurudhore pajisen me mjedise të përshtatshme për pranimin, ruajtjen dhe transportin e bagazheve.

Neni 63
Tarifat

1. Ministri i Transporteve dhe Ministri i Financave, me udhëzim të përbashkët, përcaktojnë skemën e detyrimeve të shërbimit publik, për shërbime kryesisht të udhëtarëve, të cilat për arsye sociale, mjedisore dhe të menaxhimit të territorit, si dhe për disa kategori qytetarësh, do të kompensohen financiarisht nga Buxheti i Shtetit si shërbime joefiçente.
Në periudhën kalimtare, derisa të përcaktohet kjo skemë, çmimet e biletave të udhëtimit për transportin hekurudhor të udhëtarëve miratohen nga Ministri i Financave me propozimin e Ministrisë së Transporteve.

2. Tarifat e transportit të bagazheve, me përjashtim të kolive të dorës, përcaktohen nga transportuesi hekurudhor.

Neni 64

Ruajtja e rendit publik në trenat e udhëtarëve

Ruajtja e rendit publik në trenat e udhëtarëve sigurohet nga strukturat e Policisë së Shtetit, të caktuara për këtë qëllim, të cilat ndihmojnë personelin e hekurudhës dhe Drejtorinë e Inspektimit Hekurudhor për kryerjen e detyrave të tyre funksionale, kur u kërkohet kjo ndihmë.

KREU XII

TRANSPORTI HEKURUDHOR I MALLRAVE

Neni 65

Natyra dhe funksioni

1. Transporti hekurudhor i mallrave është veprimtaria hekurudhore për qarkullimin e lëndëve të para, të produkteve bujqësore e industriale, i makinerive e pajisjeve, në funksion të prodhimit, tregtisë, konsumit, shërbimeve dhe për nevoja shtetërore të personave fizikë e juridikë.

2. Transportuesit hekurudhorë, publikë e privatë, të pajisur me leje për realizimin e transportit hekurudhor të mallrave, e kryejnë këtë shërbim në kushtet e konkurrencës së lirë ndërmjet tyre dhe me llojet e tjera të transportit.

Neni 66

Rregullimi ligjor

1. Detyrimet e ndërsjella të transportuesve hekurudhorë, të nisësve dhe pritësve të mallrave, përcaktohen në kontratë, e cila hartohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Rregullorja për mënyrën e ngarkimit të mallrave në vagonët hekurudhorë dhe rregullorja për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme miratohen nga ministri.

Neni 67

Tarifat e transportit hekurudhor të mallrave

Tarifat e transportit hekurudhor të mallrave përcaktohen nga transportuesit hekurudhorë.

Neni 68

Transporti i përzier

1. Në trenat e udhëtarëve mund të vendosen vagonë vetëm për transportin e bagazheve.

2. Përjashtimisht, për rastet e mallrave që nuk presin dhe nëse është e mundur teknikisht, lejohet që trenit të udhëtarëve t'i bashkëlidhen edhe vagonë për transportin e mallrave, pasi është marrë leje në dispecerinë qendrore të HSH-së.

3. Trenit të udhëtarëve nuk mund t'i bashkëlidhen vagonë mallrash, për transportimin e mallrave që paraqesin rrezikshmëri ose që shqetësojnë udhëtarët.

KREU XIII

AFTËSIMI PROFESIONAL I PUNONJËSVE TË HEKURUDHAVE

Neni 69

Kriteri i aftësisë profesionale

Punonjësit e hekurudhave, që marrin pjesë në veprimtaritë e ndryshme të transportit

hekurudhor, të mirëmbajtjes dhe të funksionimit të hekurudhave duhet të kenë përgatitjen e duhur profesionale, të vërtetuar me dëshmi aftësie, për realizimin e garantimit të trafikut hekurudhor.

Neni 70

Verifikimi i aftësisë për marrje në punë

1. Punonjësit që merren rishtas në punë nga transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e infrastrukturës duhet të kenë kryer kurset përkatëse të kualifikimit profesional, të organizuar nga HSH-ja.

2. Pavarësisht nga fitimi i aftësisë profesionale në shkollë të kursit, për marrjen në punë në sektorët e drejtimit dhe të lëvizjes së trenave, në drejtimin e mjeteve tërheqëse, për mekanikët kontrollorë të trenave dhe për drejtuesit e mirëmbajtjes zonale të vijave hekurudhore zbatohet një periudhë prove jo më pak se tre muaj. Kjo periudhë prove synon verifikimin e përgatitjes profesionale dhe aftësimin real për kryerjen e veprimeve dhe zhvillohet nën kujdesin e mbikëqyrjes së punonjësve të kualifikuar.

Neni 71

Verifikimet periodike

1. Aftësia e punonjësit në marrëdhënie pune kontrollohet me anë të marrjes në provim, në mënyrë periodike.

2. Punonjësit merren në provë dhe pajisen me dëshmi aftësie nga një komision i veçantë, që ngrihet pranë Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor.

3. Komisioni, përbërja e tij, llojet, format dhe përmbajtja e dëshmive të aftësisë, kushtet dhe kategoritë e punonjësve, që pajisen me dëshmi, afatet e vlefshmërisë së saj, heqja e dëshmive, si dhe rikontrolli i aftësive e rregullat e tjera më të hollësishme përcaktohen në një rregullore të veçantë të miratuar nga ministri.

Neni 72

Aftësimi dhe riaftësimi profesional

Aftësimi dhe riaftësimi profesional i punonjësit janë të detyrueshëm edhe kur në detyrën ose në vendin e punës vihen në përdorim makineri ose aparatura të reja ose kur bëhen rikonstruksione thelbësore në procesin teknologjik.

Neni 73

Aftësimi i punonjësve të vijave të brendshme

Punonjësit hekurudhorë të vijave të brendshme hekurudhore të personave juridikë, për një trafik hekurudhor të sigurt, janë të detyruar të aftësohen, të riaftësohen dhe të pajisen me dëshmi aftësie, sipas dispozitave të këtij Kodi dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij.

KREU XIV

DETYRIME NË RASTET E FATKEQËSIVE NATYRORE, AVARIVE DHE AKSIDENTEVE NË HEKURUDHA

Neni 74

Marrja e masave në rastet e fatkeqësive natyrore, avarive dhe aksidenteve në hekurudha

Në rastet e fatkeqësive natyrore, avarive dhe aksidenteve në hekurudha, transportuesi hekurudhor dhe administruesi i infrastrukturës janë të detyruar, sipas përgjegjësisë, të marrin masa për shpëtimin e udhëtarëve, për të ndihmuar personat e dëmtuar, për parandalimin dhe për ruajtjen e bagazheve e të mallrave, si dhe të marrin masa për ruajtjen e gjurmëve për këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe gjetjen e shkaqeve, si dhe të rivendosin trafikun hekurudhor.

Neni 75

Këqyrja e vendit të ngjarjes

Në rastet e avarive dhe aksidenteve, transportuesit hekurudhorë, administruesit e infrastrukturës, si dhe organet kompetente që bëjnë këqyrjen e vendit të ngjarjes, për aq sa është e mundur, janë të detyruar të kryejnë veprimet përkatëse pa ndërprerë trafikun hekurudhor.

Neni 76

Analiza e rasteve të avarive dhe aksidenteve

1. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, në bashkëpunim me transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e infrastrukturës, është e detyruar të analizojë rastet e fatkeqësive natyrore me pasoja në hekurudha, si dhe të përcaktojë shkaqet e ndodhjes së avarive dhe aksidenteve në trafikun hekurudhor, pavarësisht nga natyra, përmasat e pasojat, duke përcaktuar përgjegjësitë përkatëse.

2. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor bashkëpunon me organet e policisë gjyqësore dhe ato të prokurorisë gjatë kryerjes prej tyre të veprimeve përkatëse në vendin e ndodhjes së avarive dhe aksidenteve.

Neni 77

Njoftimi i organeve të tjera shtetërore

Punonjësit e transportuesve hekurudhorë dhe administruesve të infrastrukturës, për rastet e fatkeqësive natyrore, avarive dhe aksidenteve në hekurudha, njoftojnë ministrinë që mbulon transportin, organet e Rendit Publik dhe qendrën me të afërt shëndetësore, si dhe janë të detyruar të japin ndihmën e parë.

KREU XV

ORGANET E KONTROLLIT, DETYRAT DHE TË DREJTAT E TYRE, KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE DËNIMET

Neni 78

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor ngarkohet për kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij Kodi.

Kjo Drejtori, e cila është në varësi të ministrisë që mbulon transportet, ka për detyrë kontrollin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore dhe garantimin e zbatimit të rregullave për:

- a) mbrojtjen, mirëmbajtjen, remontin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës hekurudhore;
- b) lëvizjen e sigurt të trenave;
- c) kontrollin teknik të mjeteve lëvizëse gjatë shfrytëzimit të tyre;
- ç) të gjitha procedurat e ndjekura gjatë pranimit për shfrytëzim të mjeteve hekurudhore.

Neni 79

Masat ndëshkimore që merr Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, kur vëren shkelje dhe parregullsi në zbatimin e dispozitave të këtij Kodi, merr këto masa:

- a) pezullon shfrytëzimin e vijave hekurudhore, të cilat paraqesin rrezikshmëri për lëvizjen e trenave dhe të mjeteve hekurudhore;
- b) pezullon lëvizjen e trenave dhe të mjeteve hekurudhore, që nuk plotësojnë kushtet për një lëvizje të sigurt;
- c) ndërpret punimet në vijat hekurudhore dhe në brezin e vijës hekurudhore, nëse verifikon se këto punime rrezikojnë lëvizjen e trenave;

- c) pezullon ngarkesat e parregullta të vagonëve;
- d) pezullon nga detyra punonjës in për veprime ose mosveprime në kundërshtim me rregullat. Në rast pezullimi të punonjës it, komunikon me eprorin më të afërt për zëvendësimin e tij.
- dh) njofton organet përkatëse për shkeljen e dispozitave të këtij Kodi.

Neni 80 **Kontrolli i brendshëm**

Personat juridikë, publikë e privatë, që kryejnë veprimtari hekurudhore, realizojnë kontrollin e tyre të brendshëm për zbatimin e rregullave të përcaktuara në këtë Kod, nëpërmjet organizmave të tyre të kontrollit, sipas detyrave të përcaktuara në aktet themeluese, në statute dhe në rregulloret e brendshme.

Neni 81 **Lejimi i veprimtarisë hekurudhore**

1. Personat fizikë dhe juridikë, të cilët kryejnë punime në vijën hekurudhore ose në afërsi të saj, janë të detyruar që t'i mundësojnë inspektorit të Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor kryerjen e inspektimit dhe t'i japin sqarimet e duhura dhe dokumentacionin teknik të nevojshëm.

2. Transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e infrastrukturës janë të detyruar që, me kërkesë të Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor, t'i dërgojnë asaj të dhëna për gjendjen e vijave hekurudhore, të mjeteve hekurudhore dhe për mbarëvajtjen e punës në trafikun hekurudhor.

Neni 82 **Kundërvajtjet administrative**

1. Shkelja e dispozitave, të parashikuara në nenet 15, 18, 22, 23, 24, 25, 29, 32, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 42, 43, 45, 46, 48, 49, 50, 53 dhe 77 të këtij Kodi, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative.

2. Për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative ngrihet një komision pranë Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor, në të cilin bëjnë pjesë edhe ekspertë të transportuesve hekurudhorë. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative bëhet në përputhje me ligjin "Për kundërvajtjet administrative".

3. Përbërja, kompetencat dhe fusha e veprimit të këtij komisioni përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri.

Neni 83 **Sanksionet**

1. Për shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative, në bazë të nenit 82, komisioni i shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative jep dënimet si më poshtë:

a) gjobë nga 2 000 deri në 5 000 lekë për punonjës in e transportuesve dhe të administruesve hekurudhorë për shkelje të neneve 15, 25, 26, 34, 39, 40, 42, 43, 45, 46, 48 shkronjat "a" dhe "ç", nenit 49 shkronjat "c" dhe "ë", neneve 53 dhe 77 të këtij Kodi;

b) gjobë nga 5000 deri në 200 000 lekë për shkeljet e kryera nga transportuesit, administruesit dhe personat e tjerë juridikë të neneve 18, 22, 23, 24, 29, 32, 35, 36, 37, 38 dhe 50 të këtij Kodi.

2. Inspektori i Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor ka të drejtën e vënies së gjobës në vend në masën 1 000 lekë për shkeljet e nenit 48 shkronjat "d", "dh" dhe "e" dhe nenit 49 shkronjat "a", "b", "ç", "d", "dh", "e", "f", "g", "gj" dhe "h" të këtij Kodi.

3. Të gjithë transportuesit hekurudhorë, nëse vërejnë shkeljet që përbëjnë kundërvajtje

administrative, të përmendura në nenin 82, krahas ndërhyrjeve tek organet kompetente, njoftojnë për to edhe Drejtorinë e Inspektimit Hekurudhor.

Neni 84

Ankimi

1. Kundër vendimit të ndëshkimit me gjobë në vend nga ana e inspektorit të Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor mund të bëhet ankim në komisionin e ngritur pranë kësaj Drejtorie brenda 10 ditëve nga data e dhënies së tij. Ky komision merr vendim brenda 30 ditëve nga data e ankimit.

2. Ndaj vendimeve të komisionit të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin "Për kundërvajtjet administrative".

3. Gjopa vilet nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Neni 85

Shfuqizime

1. Ligji nr. 7224, datë 22.6.1988 "Kodi Hekurudhor i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", shfuqizohet.

2. Aktet ligjore dhe nënligjore, që kanë për objekt ose lidhje me veprimtarinë që mbulon ky Kod, mbeten në fuqi deri në daljen e akteve të reja, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me të.

Neni 86

Nxjerrja e akteve nënligjore

Për nxjerrjen e akteve nënligjore ngarkohen:

a) ministri, në zbatim të nenit 6 pikat 1 dhe 2, nenit 9 pika 2, nenit 17, nenit 21 pika 1, nenit 26 pika 2, nenit 28, nenit 29 pika 2, nenit 42, nenit 56, nenit 59, nenit 61, nenit 66 pika 2, nenit 71 pika 3 dhe nenit 82 pika 3 të këtij Kodi;

b) Ministri i Financave, në zbatim të nenit 63, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij Kodi.

Neni 87

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi tre muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4420, datë 14.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Aldred Moisiu

L I G J

Nr.9318, datë 18.11. 2004

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8615, DATË 1.6.2000 "PËR URDHRIN E MJEKËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8615, datë 1.6.2000 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i parë i nenit 9 ndryshohet si më poshtë:

"Këshilli Kombëtar përbëhet nga 21 anëtarë. Në këtë Këshill bëjnë pjesë detyrimisht: Presidenti dhe Zëvendëspresidenti i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve, presidentët e këshillave rajonalë të Urdhrit të Mjekëve, një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë, një përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, një përfaqësues i Ministrisë së Financave, një përfaqësues i Fakultetit të Mjekësisë, një përfaqësues i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe dy përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse.".

Neni 2

Paragrafi i dytë i nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

"Këshilli rajonal zgjedh presidentin dhe zëvendësit e tij. Mandati i presidentit është 5 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje.".

Neni 3

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 16

Shteti i jep Urdhrit të Mjekëve një mbështetje buxhetore, në formë transferte, për vitet 2004 e 2005.".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4419, datë 14.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Aldred Moisiu**

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-eksponitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500
5.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 17.12.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë